# 6. SISTEMI FINANCIAR

Grafik 31. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit financiar, qershor 2019.




Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

**(33) Pesha e totalit të aktiveve të sistemit financiar ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) ra në 104.8%[22], nga 106.9% në fund të vitit 2018.** Rënia e peshës së sistemit financiar reflekton tkurrjen e aktiveve të sektorit bankar të ardhur si pasojë e thyerjes strukturore të të dhënave[23]. Në fund të periudhës, pesha e sektorit bankar ra në 93.6%, nga 96% në fund të vitit 2018; pesha e sektorit jobankar u rrit në 11.2%, nga 10.7%, si rrjedhojë e zgjerimit të veprimtarisë së institucioneve financiare jobanka dhe fondeve të investimit. Treguesit e performancës së sistemit financiar, duke përfshirë ata të kapitalizimit, të përfitueshmërisë, të likuiditetit dhe të cilësisë së aktiveve, mbeten në nivele të mira.

*Tabelë 5. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite*

| Autoriteti Licencues dhe Mbikëqyrës | Sistemi financiar | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Banka e Shqipërisë | Sektori bankar | 88.1 | 92.1 | 94.8 | 97.6 | 97.3 | 100.5 | 99.4 | 96.8 |
| | Institucione jobanka | 2.7 | 2.7 | 2.7 | 3.0 | 2.9 | 3.0 | 3.1 | 3.3 |
| | SHKK dhe unionet e tyre | 0.8 | 0.8 | 0.7 | 0.8 | 0.8 | 0.6 | 0.6 | 0.6 |
| Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare | Shoqëri sigurimi | 1.5 | 1.6 | 1.7 | 1.9 | 2.1 | 2.1 | 2.1 | 2.2 |
| | Fonde pensioni | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 |
| | Fonde investimi | | 1.2 | 3.9 | 4.8 | 5.0 | 4.7 | 5.0 | 4.5 |
| Ndërmjetësimi financiar | | 93.1 | 98.6 | 103.8 | 108.2 | 108.0 | 111.0 | 110.3 | 107.6 |

## 6.1. SEKTORI BANKAR

**(34) Efekti i thyerjes strukturore ka ndikuar në rënien e aktiveve të sektorit bankar gjatë periudhës.** Si rezultat, vlera e raportuar e aktiveve ra me rreth 30 miliardë lekë gjatë periudhës, duke arritur në rreth 1,420 miliardë lekë. Kontributin kryesor në rënien e aktiveve e ka dhënë tkurrja e investimeve në tituj dhe zvogëlimi i portofolit të kredisë për jorezidentët në valutë me nga 19 miliardë lekë. Nga të

[22] *Analiza e bilancit të sektorit bankar i referohet gjysmës së parë të vitit 2019, ndërsa për segmentet e tjera të sistemit financiar (jobankat, shoqëritë e kursim-kreditit, shoqëritë e sigurimit, fondet e pensionit dhe fondet e investimit), bilancet i përkasin tremujorit të parë të vitit 2019, sipas raportimeve më të fundit pranë Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Tremujori i fundit për të cilin disponohen të dhëna për PBB-në është tremujori i parë i vitit 2019, sipas publikimit më të fundit nga Instituti i Statistikave.*

[23] *Shiko tek "Sqarime" në hyrje të raportit.*

gjithë zërat e aktivit të sektorit bankar, kredia për jorezidentët është zëri që është prekur më tepër nga thyerja strukturore. Zgjerimi i investimeve ndërbankare në formën e llogarive rrjedhëse në institucione financiare, zbuti kontributin negativ të veprimeve me thesarin dhe ndërbankare. Pakësimi i fondeve rezervë përmirësoi ecurinë e aktiveve me rreth 4 miliardë lekë. Nëse do të korrigjohej për efektin e thyerjes strukturore, aktivi i sektorit bankar do të shënonte një rritje prej 1.3% gjatë periudhës dhe prej 2% në terma vjetorë.

*Tabelë 6. Struktura e bilancit të bankave dhe ndryshimi vjetor, qershor 2019*

| Aktivi | % e aktiveve | Ndryshimi vjetor, % | Pasivi | % e pasiveve | Ndryshimi vjetor, % |
|---|---|---|---|---|---|
| I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare | 32.9 | 0.2 | I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare | 5.8 | 13.9 |
| II. Veprime me klientët (Kredia) | 39.3 | -3.4 | II. Veprime me klientët (Depozita) | 80.2 | -0.04 |
| Nga e cila: për sektorin publik | 2.0 | 1.0 | Nga të cilat: të sektorit publik | 1.9 | -3.3 |
| Nga e cila: për sektorin privat | 37.5 | -3.7 | Nga të cilat: të sektorit privat | 78.6 | 0.05 |
| III. Veprimet me letrat me vlerë | 25.7 | -0.5 | III. Veprimet me letrat me vlerë | 0.6 | -29.3 |
| IV. Fonde rezervë të krijuara | -2.8 | -24.4 | IV. Detyrime të tjera | 1.0 | -8.0 |
| V. Të tjera* | 4.9 | 7.7 | V. Burimet e përhershme | 12.1 | -4.4 |
| | | | Nga të cilat: Borxhi i varur | 1.0 | -30.4 |
| | | | Nga të cilat: Kapitali aksioner | 10.4 | -0.7 |
| Totali i aktiveve | 100 | -0.2 | Totali i pasiveve | 100 | -0.2 |

*Burimi: Banka e Shqipërisë.*

**(35) Mbiçmimi i lekut ndaj valutave kryesore ka dhënë një efekt neto negativ në bilancin në valutë të sektorit bankar, por ky efekt ka pasur kahe të ndryshme në dy tremujorët e parë të vitit.** Kështu, nënçmimi i lekut gjatë tremujorit të parë dhe mbiçmimi i tij gjatë tremujorit të dytë të vitit, ka bërë që efekti statistikor i kursit të këmbimit në vlerën e raportuar të bilancit valutor të sektorit bankar në secilin tremujor të ishte përkatësisht pozitiv (+15 mld lekë) dhe negativ (-18 mld lekë). Në fund të periudhës, aktivet dhe pasivet në valutë të sektorit bankar zinin përkatësisht 52.4% dhe 51% të totalit të bilancit, dhe këto raporte kanë shënuar rënie të lehtë në krahasim me periudhat e kaluara. Në anën e aktivit, efekti i kursit ka qenë më i fortë në veprimet me thesarin

Grafik 32. Efekti i kursit të këmbimit në ecurinë në kundërvlerën në lekë të zërave kryesorë të aktivit (majtas) dhe pasivit (djathtas)




*Burimi: Banka e Shqipërisë.*

dhe ato ndërbankare dhe në veprimet me klientët (kredinë), ndërsa në anën e pasivit, pothuajse i gjithë efekti statistikor i kursit të këmbimit është reflektuar në kundërvlerën në lekë të depozitave në valutë. Në krahasim me gjysmën e parë të vitit të kaluar, efekti i kursit të këmbimit ka qenë dukshëm më i vogël për shkak të ndryshimit të pirjes në ecurinë e monedhës euro ndaj monedhës vendase gjatë periudhës janar - mars të vitit 2019. Analiza në vijim duhet të interpretohet marrë në konsideratë edhe efektin statistikor të kursit të këmbimit në kundërvlerën në lekë të bilancit valutor të bankave.

**(36) Depozitat dhe fondet e veta vijojnë të përbëjnë burimet kryesore të financimit të veprimtarisë së sektorit bankar, duke zënë mbi 90% të totalit të pasivit dhe kjo strukturë nuk ka shënuar ndryshime të dukshme gjatë periudhës.** Varësia ndaj burimeve të huaja të financimit vijon të mbetet e kufizuar dhe ka shënuar rënie të mëtejshme gjatë periudhës. Si pasojë e efektit të thyerjes strukturore, detyrimet ndaj jorezidentëve në formën e depozitave të jorezidentëve janë pakësuar dukshëm. Në të njëjtën kohë, është evidentuar rënie edhe në portofolin e kredisë për jorezidentët, gjë që ka ndikuar në rënien e pozicionit kreditor neto të sektorit bankar.

Grafik 33. Struktura e detyrimeve jorezidente




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 34. Pozicioni neto me jorezidentët




Burimi: Banka e Shqipërisë.
*Vija e zezë vertikale (grafiku djathtas) pasqyron periudhën e transformimit të degës së BKT në filial.

**(37) Efekti i thyerjes strukturore në aktivet dhe detyrimet me jorezidentët ka qenë pothuajse i të njëjtës masë dhe pozicioni kreditor neto ndaj jorezidentëve ka mbetur i pandryshuar në 20% të totalit të bilancit të sektorit bankar.** Në fund të periudhës, pretendimet ndaj jorezidentëve zunë 23% të totalit të aktiveve, ndërsa detyrimet ndaj jorezidentëve ishin sa 3% e totalit të bilancit. Që nga mesi i vitit 2016 deri në fillim të vitit 2019, pesha e pretendimeve dhe detyrimeve ndaj jorezidentëve ka ruajtur nivele relativisht të qëndrueshme (përkatësisht 27% dhe 6%), dhe pozicioni kreditor neto i sektorit bankar ka mbetur thuajse i pandryshuar, në vlerën 300 miliardë lekë. Ndryshimet strukturore janë reflektuar në rënien e vlerës absolute dhe peshës relative të

detyrimeve dhe pretendimeve ndaj jorezidentëve, si edhe të madhësisë së pozicionit kreditor neto, por ky i fundit ka ruajtur peshë relative të njëjtë ndaj totalit të bilancit të sektorit bankar, prej rreth 20%.

### 6.1.1 KREDIA

**(38) Në fund të periudhës, teprica e kredisë së sektorit bankar rezultoi rreth 562 miliardë lekë.** Për shkak të efektit të thyerjes strukturore, teprica e kredisë ishte 3.3% dhe 3.5% më pak në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Gjatë periudhës, mbështetur në ndryshimet mujore, ecuri veçanërisht e mirë është regjistruar në kredinë për individët, kredinë në lekë dhe kredinë afatgjatë, ndërkohë që kredia në valutë, ajo afatmesme dhe ajo afatshkurtër kanë vijuar të tkurren. Sipas performancës, klasat e kredive me rënien më të madhe ishin ato të kredive performuese (kreditë "standarde" dhe ato "në ndjekje").

*Tabelë 7. Të dhëna mbi kategoritë kryesore të kredisë*

| | | Mld lekë | % ndaj totalit | | Ndryshimi (%) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Periudha | 06/2019 | 06/2018 | 06/2019 | 6-mujor | Vjetor | 6-mujor* | Vjetor* |
| Sipas afatit | Afatshkurtër | 159,880 | 29 | 28 | (3.6) | (6.6) | (2.4) | (5.5) |
| | Afatmesëm | 94,883 | 18 | 17 | (14.4) | (11.3) | 7.5 | 11.4 |
| | Afatgjatë | 306,951 | 52 | 55 | 1.0 | 0.9 | 5.0 | 4.9 |
| Sipas subjektit | Sektori publik | 27,829 | 5 | 5 | (0.4) | 1.0 | (0.4) | 1.0 |
| | Biznese | 352,635 | 64 | 63 | (4.2) | (5.6) | 2.8 | 1.3 |
| | Individë | 181,305 | 31 | 32 | (1.8) | (0.0) | 4.9 | 6.9 |
| Sipas monedhës | Kredia në lekë | 263,507 | 44 | 47 | 3.3 | 3.9 | 3.6 | 4.2 |
| | Kredia në valutë | 298,262 | 56 | 53 | (8.4) | (9.3) | 3.1 | 2.1 |
| | Stoku i kredisë | 561,769 | 100 | 100 | (3.3) | (3.5) | 3.3 | 3.1 |

*'* - duke përjashtuar efektin e thyerjes strukturore*
*Burimi: Banka e Shqipërisë.*

**(39) Mbiçmimi i lehtë i lekut ndaj euros dhe dollarit amerikan ka dhënë një efekt pakësues më të ulët në kundërvlerën në lekë të kredisë në valutë.** Gjatë 12 muajve të fundit, kontributin kryesor në këtë efekt pakësues e ka dhënë kursi i këmbimit euro/lek. Në përgjithësi, në terma vjetorë, vlerësohet që efekti pakësues i mbiçmimit të lekut për kredinë në valutë dhe për kredinë totale në normën e rritjes ka qenë përkatësisht 2 dhe 1.3 pikë përqindjeje.

**(40) Gjatë periudhës, bankat kanë vijuar procesin e largimit të kredive të humbura nga bilancet, por me ritme të ulëta.** Vlera e kredive të fshira gjatë 12 muajve të fundit deri në qershor 2019 ishte 6.4 miliardë lekë, por pjesa dërrmuese e fshirjeve është realizuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018. Stoku i kredive të fshira është sa rreth 10% e tepricës së përgjithshme të kredive me probleme deri në fund të qershorit 2019, dhe ka ndikuar në pakësimin e ndryshimit vjetor të kredisë me gati 1.1 pikë përqindjeje.

Grafik 35. Ecuria e kredisë totale, pa efektin e kursit dhe fshirjeve (majtas) dhe e kredisë në valutë pa efektin e kursit (djathtas), ndryshime vjetore, në %




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(41) Nëse do të përjashtohej efekti i ndryshimit strukturor, kredia do të shënonte një rritje me rreth 19 miliardë lekë ose me 3.3% gjatë periudhës, dhe me 3.1% kundrejt një viti më parë.** Me përjashtim të kredisë afatshkurtër dhe të asaj për sektorin publik, të gjithë agregatët e tjerë do të shënonin vlera pozitive të rritjes, si në krahasim me fundin e vitit të kaluar, ashtu edhe ndaj një viti më parë.

Grafik 36. Ndryshimi 6–mujor në tepricën e kredisë sipas elementeve përbërëse (pa efektin e ndryshimit strukturor)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 37. Ecuria e kredisë sipas sektorëve - kontribut në pikë përqindjeje, ndryshime gjashtëmujore (pa efektin e ndryshimit strukturor)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## *KREDIA PËR SUBJEKTET REZIDENTE – BIZNESI*

**(42) Kredia për subjektet rezidente[24] u zgjerua me 3.1% gjatë periudhës. Kjo kredi zë rreth 96% të totalit të kredisë.** Mbi 60% e kredisë për subjektet

[24] *Kjo kredi nuk është ndikuar nga thyerja strukturore.*

rezidente mbahet nga sektori i biznesit. Kredia për këtë sektor është zgjeruar me rreth 10 miliardë lekë dhe në fund të periudhës arriti në rreth 330 miliardë lekë. Rritja në këtë kategori ka ardhur nga rritja në kredinë për kapital qarkullues dhe kredinë për pasuri të paluajtshme. Kjo e fundit vijon të zërë rreth 27% të tepricës së kredisë për bizneset.

Grafik 38. Ecuria e kredisë për bizneset rezidente




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(43) Gjatë viteve të fundit janë vërejtur ndryshime në strukturën e kredisë për bizneset.** Pesha e kredisë "Overdraft" ka ardhur në rënie, si pasojë e rënies së pjesës në valutë të kësaj lloj kredie. Ecuri të ngjashme ka pasur edhe kredia "për blerje pajisjesh". Pesha e kredisë për "blerje pasurish të paluajtshme" në tepricën e kredisë së bizneseve është rritur lehtë gjatë dy viteve të fundit, e ndikuar nga rritja me gati 7% e portofolit në valutë.

Grafik 39. Ecuria e kredisë për bizneset sipas qëllimit të përdorimit dhe valutës, indeks, dhjetor 2016 = 100)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(44) Gjatë periudhës, peshat e kredisë për biznesin e madh dhe të mesëm ndaj totalit të kredisë për bizneset rezidente janë rritur, ndërsa pesha e kredisë për biznesin e vogël[25] ka rënë.** Biznesi i vogël dhe biznesi i madh kanë zgjeruar portofolin e kredisë afatgjatë dhe kanë pakësuar portofolin e kredisë afatshkurtër. Për grupin e bizneseve të mesme, vërehet një zgjerim i portofolit të kredisë afatshkurtër dhe një tkurrje e portofolit të kredisë afatgjatë.

[25] *Këto vlera shënonin përkatësisht: 50.8% (biznes i madh); 23.0% (biznes i mesëm) dhe 26.2% (bizes i vogël) në dhjetor të 2018-ës; ndërsa në qershor të 2018-ës, ato ishin përkatësisht: 52.7%; 22.9%; dhe 24.4%.*

Grafik 40. Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë dhe afatit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## *KREDIA PËR SUBJEKTET REZIDENTE – INDIVIDËT*

**(45) Kredia për individët rezidentë u zgjerua me 3% gjatë periudhës dhe kontributin kryesor në këtë rritje e ka dhënë rritja e kredisë në lekë.** Rritja më e shpejtë është regjistruar në kredinë për pasuri të paluajtshme dhe në kredinë për konsum të mallrave jo të qëndrueshme, që zënë përkatësisht 62% dhe 17% të kredisë për individët. Teprica e kredisë për pasuri të paluajtshme u rrit me rreth 3% dhe arriti në 113 miliardë lekë. Në krahasim me një vit më parë, kredia për individët është zgjeruar me 5%. Gjatë periudhës 2015-2018, është vënë re rritje e vazhdueshme e kredisë për individët nga njëra anë, dhe rënie e kredisë për bizneset nga ana tjetër. Kjo ecuri ka sjellë ndryshime në strukturën e kredisë sipas sektorëve, në favor të kredisë për individët. Kredia për individët në qershor të vitit 2019 zinte 32% të tepricës së kredisë, kundrejt 31% një vit më parë dhe 25% në fillim të vitit 2015.

Grafik 41. Ecuria e kredisë për individët rezidentë sipas qëllimit të përdorimit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## KREDIA PËR SUBJEKTET JOREZIDENTE

**(46) Gjatë periudhës, si rezultat i efektit të thyerjes strukturore, kredia për subjektet jorezidente, pësoi rënie të ndjeshme.** Në qershor të vitit 2019, kredia për jorezidentët ishte rreth 25 miliardë lekë dhe zinte 4.5% të tepricës së kredisë të sektorit bankar, nga përkatësisht 60 miliardë lekë dhe 10% në fund të gjashtëmujorit paraardhës. Sipas sektorit, afatit dhe monedhës, rënia më e madhe është regjistruar në kredinë për bizneset, atë në monedhën euro dhe kredinë afatmesme, të cilat ishin kategoritë me peshën më të madhe në stokun e kredisë për subjektet jorezidente.

Grafik 42. Kredia për rezidentët dhe jorezidentët (majtas) dhe kredia për jorezidentët sipas afatit (djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## KREDIA E PAMBROJTUR NË VALUTË

**(47) Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i pasqyruar në peshën e kredisë së pambrojtur në valutë, vijon të mbetet i lartë.** Kredia e pambrojtur në valutë ka pasur ecuri të ngjashme me portofolin e përgjithshëm të kredisë, dhe ka rënë me 2% dhe 3.5% në krahasim me 6 muaj dhe një vit më parë. Efekti i kursit të këmbimit në ndryshimin gjashtëmujor të portofolit të kredisë së pambrojtur ishte rreth -0.4 pikë përqindjeje. Rënia është regjistruar në të gjitha llojet e kredisë së pambrojtur sipas sektorëve, por kontributin kryesor e ka dhënë sektori i qeverisë. Pesha e kredisë së pambrojtur ndaj tepricës së përgjithshme të kredisë ka mbetur e pandryshuar në 24%, por pesha e saj ndaj portofolit të kredisë në valutë, gjatë gjysmës së parë të vitit 2019, u rrit në 46%, nga 43%.

*HAPËSIRË INFORMUESE 6.1: SEKTORI BANKAR DHE KREDIA E PAMBROJTUR NË VALUTË*

*Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, kredia e pambrojtur në valutë ra me 2%, në nivelin 136 miliardë lekë, kryesisht për shkak të tkurrjes së kredisë së pambrojtur në monedhën USD[1] (me 18%), ndërkohë që kredia e pambrojtur në euro ka regjistruar një rritje të lehtë. Kredia për bizneset përbën 70% të tepricës së kredisë në valutë të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ndërsa kredia për individët dhe ajo për qeverinë zënë përkatësisht 25% dhe 4%. Rënia me 20% e kredisë së pambrojtur për qeverinë ka dhënë kontributin kryesor në tkurrjen e tepricës së kredisë së pambrojtur. Kredia e pambrojtur për individët dhe ajo për bizneset, gjithashtu shënuan rënie gjatë periudhës me përkatësisht 1.2% dhe 1%. Në terma vjetorë, kredia e pambrojtur në valutë u tkurr me 3.5%, si pasojë e rënies në kredinë për individët dhe në kredinë në monedhën euro.*

Grafik 43. Ecuria e kredisë së pambrojtur në valutë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 44. Përbërja e kredisë së pambrojtur në valutë sipas qëllimit të përdorimit, në %




Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Kredia e pambrojtur e dhënë për investime në pasuri të paluajtshme vijon të mbajë peshën kryesore (rreth 53%) të totalit të kredisë së pambrojtur në valutë, pasuar nga kredia për tregti (me 26%). Pjesa tjetër e kredisë së pambrojtur në valutë është dhënë për zhvillim biznesi, konsum, për qeverinë dhe qëllime të tjera. Kontributin kryesor në ecurinë e tepricës së kredisë së pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit gjatë periudhës e dhanë rënia e kredisë së pambrojtur për "tregti" dhe për "Qeverinë", të cilat ranë me 10% dhe 20%. Kredia e pambrojtur në valutë për "investime në pasuri të paluajtshme" ishte e vetmja kategori e kredisë së pambrojtur që shënoi rritje gjatë periudhës (+7%).*

*Kredia e pambrojtur për pasuri të paluajtshme është dhënë për blerje të pasurive të paluajtshme rezidenciale, atyre komerciale dhe për blerje toke. Peshën kryesore të saj e zë kredia e pambrojtur për pasuri të paluajtshme rezidenciale dhënë individëve (42%), e cila u zgjerua me 4% gjatë periudhës. Kontributin kryesor në zgjerimin e kredisë së pambrojtur për pasuri të paluajtshme gjatë periudhës e dha rritja me 10% e këtyre kredive për qëllime komerciale. Për të gjitha kategoritë e kredive për pasuri të paluajtshme të pambrojtura nga kursi i këmbimit, bankat raportojnë zgjerim të stokut. Mbiçmimi i kursit të këmbimit*

*të lekut, ka ndikuar negativisht vlerën e raportuar të kredisë së pambrojtur në valutë (me 0.6 miliardë lekë). Vlerësohet që në mungesë të mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut, kredia e pambrojtur në valutë do të ishte tkurrur me 1.6% nga 2% gjatë periudhës.*

Grafik 45. Ecuria gjashtëmujore e kredisë së pambrojtur në valutë (kontributi sipas sektorëve)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 46. Kredia e pambrojtur në valutë për pasuri të paluajtshme dhe cilësia e saj




Burimi: Banka e Shqipërisë.

[1] *Teprica e kredive në USD për të cilat të ardhurat e huamarrësit janë në lekë, zë 11.3% të tepricës së kredisë të pambrojtur në valutë.*

**(48) Kredia e re e dhënë gjatë periudhës shënoi rënie në krahasim me dy periudhat paraardhëse, duke reflektuar efektin e thyerjes strukturore.** Kontributin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë kredia e re afatshkurtër në valutë për biznesin, e cila ra me gati 20%. Për sektorin e individëve, për të cilin efekti i thyerjes strukturore është i papërfillshëm, kredia e re ishte disi më e lartë në krahasim me

Grafik 47. Kredia e re për bizneset (majtas) dhe individët (djathtas) sipas qëllimit të përdorimit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

gjashtëmujorin e kaluar dhe në krahasim me mesataren e secilit gjashtëmujor gjatë dy viteve të fundit. Kjo kredi shkoi kryesisht për blerje banese. Gjatë periudhës, u dhanë kredi të reja në vlerën 117 miliardë lekë, ose gati 13% më pak në krahasim me periudhën paraardhëse, dhe nën nivelin mesatar për çdo gjashtëmujor të dy viteve të fundit. Sipas monedhës, kredia e re në euro, e cila zinte 39% të fluksit të përgjithshëm të kredisë së re, gjatë periudhës u zvogëlua me 13%.

**(49) Norma e ponderuar e interesit për kreditë e reja të dhëna gjatë periudhës[26] shënoi rënie, dhe kjo rënie është regjistruar në normat e interesit për të gjitha llojet e kredisë.** Në qershor të 2019-ës, norma mesatare e peshuar e kredive të reja shënoi vlerën 5.1%, duke qenë rreth 0.5 pikë përqindjeje më e ulët sesa norma mesatare për kreditë e reja të dhëna gjatë vitit 2018. Rënia më e fortë është regjistruar në normat e interesit për kredinë e re në USD dhe për kredinë e re për bizneset. Në fund të periudhës, norma e peshuar e interesit të kredisë së re në lekë shënoi 5.7%, ndërsa normat për kreditë e dhëna në euro dhe në dollarë amerikanë shënuan përkatësisht 3.6% dhe 4.2%. Norma e interesit për kredinë e re për individët vijon të mbetet më e lartë në krahasim me atë të kredisë për bizneset, ndërkohë që për të dyja këto kategori kredie bankat kanë raportuar rënie të normës së peshuar të interesit gjatë dy viteve të fundit. Në muajin qershor të vitit 2019, norma e ponderuar e kredisë për individët shënoi vlerën 5.9%, nga 6.2% në dhjetor të 2018-ës, ndërsa ajo për bizneset ishte rreth 5% nga 5.6% në dhjetor të 2018-ës. Në kreditë e reja për sektorin e biznesit është vënë re një prirje për rritje të normës

Grafik 48. Ecuria e normës së peshuar të interesit për kreditë e reja




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 49. Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja, sipas monedhës




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 50. Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja, sipas subjektit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

[26] *E llogaritur si mesatare gjashtëmujore.*

së interesit për kreditë afatshkurtra dhe rënie të normës së interesit për kreditë afatgjata dhe ato për blerje pasurish të paluajtshme.

### 6.1.2 RREZIKU I KREDISË

**(50) Gjatë periudhës, treguesit e cilësisë së portofolit të kredisë nuk ka ndryshuar, ndërsa mbulimi i kredive me probleme me provigjione, kapital dhe kolateral ka shënuar rënie.** Në fund të muajit qershor, raporti i kredive me probleme, raporti i mbulimit me provigjione dhe raporti i mbulimit me kolateral arritën përkatësisht në 11.2%, 62% dhe 77.4%, krahasuar me 13.2%, 66.4% dhe 79.6% një vit më parë. Përmirësimi në cilësinë e kredisë është vërejtur kryesisht te portofoli i kredisë për individët, i kredisë në valutë dhe i kredisë afatgjatë. Kontributin kryesor në rënien e stokut të kredive me probleme e kanë dhënë shlyerjet, ristrukturimet dhe fshirjet e një pjese të kredive të humbura nga bilancet e bankave.

**(51) Në fund të periudhës, teprica e kredive me probleme shënoi vlerën 63 miliardë lekë, 18% më pak në krahasim me një vit më parë.** Në këtë rënie, kontributin kryesor e kanë dhënë shlyerjet, kalimi i disa kredive me probleme në klasat performuese ("standard" dhe "në ndjekje") dhe fshirja e një pjese të kredive të humbura. Fshirja e kredive të humbura[27] nga bilancet e bankave ka vijuar edhe gjatë gjysmës së parë të këtij viti, por ritmi i fshirjeve është ngadalësuar ndjeshëm në krahasim me vitet 2015-2017[28].

Grafik 51. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione i kredive me probleme




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 52. Kontributi në ndryshimin vjetor të stokut të kredive me probleme




Burimi: Banka e Shqipërisë.

[27] *Që prej muajit qershor 2018 janë fshirë rreth 6.4 miliardë lekë kredi të humbura, të përfaqësuara kryesisht nga kreditë e bizneseve në lekë. Rritmi i fshirjeve të kredive të humbura nga bilancet e bankave ka rënë gjatë vitit të fundit. Për të njëjtën periudhë një vit më parë, u fshinë rreth 8 miliardë lekë kredi të humbura.*

[28] *Duke filluar nga janari i vitit 2015, bankat janë të detyruara nga kërkesat rregullative për të ndërmarrë procesin e pastrimit të bilanceve – fshirjen e kredive që gjenden në kategorinë "e humbur" për më shumë se 3 vite. Gjithsej, që nga fillimi i procesit të fshirjes, janë fshirë 57.4 miliardë lekë kredi të humbura.*

**(52) Në fund të periudhës, raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë shënoi 11.2% dhe ruajti të njëjtin nivel me fundin e vitit të kaluar, por ishte 2 pikë përqindjeje më i ulët se një vit më parë.** Pesha e kredive të humbura në stokun e kredive me probleme ka rënë në 45%, nga 50% një vit më parë dhe nga 60% në mes të vitit 2017. Gjatë 12 muajve të fundit, në stokun e kredive me probleme është vënë re një rritje e dukshme e peshës së kredive "nënstandard" dhe rënie e peshës së dy kategorive të tjera. Kjo ecuri reflekton rezultatin e shlyerjeve, të ristrukturimit të kredive me probleme dhe kalimit të tyre drejt një klase më të lartë të cilësisë, si dhe të fshirjes së kredive të humbura. Sipas bankave, raportin më të lartë të kredive me probleme e kanë bankat e mëdha (12%), ndërsa raportin më të ulët e kanë bankat e vogla (8.1%). Gjatë periudhës, grupi i bankave të vogla dhe të mesme kanë regjistruar ulje të raportit të kredisë me probleme, ndërsa për bankat e mëdha ky raport kredie ka shënuar një rritje të lehtë.

Grafik 53. Struktura e kredive me probleme




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 54. Portofoli i kredive me probleme sipas grupeve bankare




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 55. Raporti i kredive me probleme sipas sektorit, monedhës dhe afatit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(53) Cilësia e kredisë paraqitet më e dobët për kredinë për bizneset, kredinë në valutë dhe kredinë me afat të mesëm maturimi.** Gjatë periudhës, kredia për subjektin biznes, ajo në lekë dhe kredia me maturitet afatshkurtër, kanë shënuar rritje të raportit të kredive me probleme, ndërsa për llojet e tjera të kredisë është vënë re një rënie e këtij raporti.

**(54) Për kredinë në valutë të pambrojtur nga luhatjet në kursin e këmbimit, cilësia është përmirësuar në krahasim me një vit më parë, por është përkeqësuar disi gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019.** Raporti i kredive me probleme për këtë lloj kredie shënoi 10.9% në fund të periudhës, diktuar nga ecuria e kredisë së pambrojtur të denominuar në monedhën

evropiane. Sipas qëllimit të përdorimit, gjatë periudhës, raporti i kredive me probleme për kredinë e pambrojtur të dhënë për blerje pasurish të paluajtshme ra në 12.8% (nga 13.6%); ai për kredinë për zhvillim biznesi (që vijon të ketë raportin më të lartë të kredive me probleme brenda kësaj kategorie) zbriti në 13% (nga 15.2%); dhe raporti për kredinë për konsum shënoi vlerën më të ulët prej 4.9%.

Grafik 56. Ecuria e kredive me probleme për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit sipas monedhave




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 57. Ecuria e cilësisë për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, sipas qëllimit të përdorimit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(55) Për portofolin e kredisë së dhënë për jorezidentët, i cili është më shumë se përgjysmuar për shkak të efektit të thyerjes strukturore, cilësia e kredisë është përmirësuar gjatë periudhës.** Raporti i kredive me probleme për kreditë e marra nga jorezidentët shënoi 2.6%, dhe ka rënë ndjeshëm nga niveli prej 5.2% i gjashtë muajve më parë. Stoku i kredive me probleme për këtë kategori është i ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë midis kredive të humbura dhe kredive të dyshimta.

Grafik 58. Ecuria në kohë e raportit të provigjionimit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(56) Gjatë periudhës, masa e mbulimit të kredive me probleme me fonde rezervë, ka shënuar rënie me 5 pikë përqindjeje, në 62%, duke reflektuar rënien më të madhe në fondet rezervë në krahasim me rënien në stokun e kredive me probleme.** Për shkak të koeficientit të lartë të ponderimit, një rënie e caktuar në stokun e kredive të humbura brenda portofolit të kredive me probleme, reflektohet në një rënie më të madhe në stokun e fondeve rezervë për kredinë.

**(57) Mbulimi me kapital i kredive me probleme neto[29] ra në 5.9 herë nga 6.6 herë gjatë periudhës.** Kjo rënie reflektoi rritjen në kredinë me probleme neto dhe rënien e lehtë të vlerës së kapitalit rregullator të sektorit bankar[30]. Në qershor të 2019-ës, raporti i kredive me probleme neto ndaj tepricës së kredisë shënoi 4.3% ose 0.5 pikë përqindjeje më shumë se muaji dhjetor i vitit 2018.

**(58) Pavarësisht një rënieje të lehtë, mbulimi me kolateral i kredisë mbetet në nivele të larta.** Në fund të periudhës, raporti i mbulimit me kolateral[31] të kredive shënoi nivelin 77.4%, duke qenë rreth 1.2 pikë përqindjeje më i ulët se ai i regjistruar në fund të vitit të kaluar dhe 2.2 pikë përqindjeje më i ulët se një vit më parë. Kreditë me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme zënë rreth 68% të kredisë së kolateralizuar dhe 53% të tepricës së kredisë. Teprica e kredisë së pakolateralizuar është zgjeruar me 2% gjatë periudhës.

**(59) Cilësia e kredisë së kolateralizuar, e përcaktuar nga ecuria e kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme, është përmirësuar gjatë periudhës.** Raporti i kredive me probleme për këtë lloj kredie shënoi 10.7% në fund të gjashtëmujorit të parë, nga rreth 12.7% një vit më parë. Rënia në stokun e kredive me probleme për kredinë e kolateralizuar ka nisur që prej vitit 2016. Në krahasim me fundin e vitit 2018, raporti i kredive me probleme për kreditë e kolateralizuara me pasuri të paluajtshme komerciale ra me 2.1 pikë përqindjeje në nivelin 11.7%. Ky është niveli më i ulët i raportuar që prej vitit 2010. Kredia e kolateralizuar me para në dorë, vijon të mbajë nivelin më të ulët të raportit të kredive me probleme. Edhe cilësia e kredisë së pakolateralizuar ka shënuar përmirësim në krahasim me fundin e periudhës paraardhëse dhe në krahasim me një vit më parë. Për kredinë e pakolateralizuar raporti i kredive me probleme ra në nivelin 13.5%, nga 14% në dhjetor të 2018-së dhe 18% në qershor të 2018-ës.

Grafik 59. Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme sipas llojit të kolateralit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

[29] *Kreditë me probleme pas zbritjes së provigjioneve.*

[30] *Si rrjedhojë e zgjerimit të tepricës së kredive me probleme neto me gati 8% dhe rënies së kapitalit rregullator me rreth 3%, raporti "kredi me probleme neto/kapitali rregullator" u ngjit në 16.9%, nga 15.2% në dhjetor të vitit 2018.*

[31] *Kolateral në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), para në dorë etj.*

*HAPËSIRË INFORMUESE 6.2: ECURIA E NUMRIT TË APLIKIMEVE PËR KREDI DHE ANALIZA E NORMËS SË REFUZIMIT NGA BANKAT NË VEND, PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2019*

*Gjatë gjashtëmujorit të parë të 2019-ës (periudha 1 dhjetor 2018 - 31 maj 2019) bankat e sistemit raportojnë se kanë marrë në shqyrtim gjithsej 50402 aplikime për kredi, ku rreth 10% i përkasin sektorit të "ndërmarrjeve" (3042 aplikime nga "ndërmarrje të vogla dhe të mesme" dhe 2066 aplikime nga "ndërmarrje të tjera"), dhe 90% i përkasin sektorit të "individëve" (45294 aplikime). Kjo strukturë ka mbetur pothuaj e pandryshuar krahasuar me një gjashtëmujor më parë (1 qershor 2018 - 30 nëntor 2018). Numri total i aplikimeve ka rezultuar 2% më i lartë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe rritja ka ardhur si nga segmenti i "ndërmarrjeve" (rritje gjashtëmujore me 4.5%), ashtu edhe nga segmenti i "individëve" (rritje gjashtëmujore me 1.7%). Në terma vjetorë, pra krahasuar me periudhën 1 dhjetor 2017 – 31 maj 2018, numri total i aplikimeve të marra në shqyrtim ka shënuar rënie të lehtë me 0.4%, e ardhur nga rënia e numrit total të aplikimeve nga ndërmarrjet me 4.6%, ndërkohë që numri i aplikimeve nga individët ka shënuar një rritje vjetore me 0.1%.*

*Të totalin e aplikimeve të marra në shqyrtim gjatë periudhës, rezulton se rreth 14% e tyre janë refuzuar nga bankat dhe kjo normë ka vijuar prirjen rritëse të konstatuar që pas 6-mujorit të dytë të vitit 2017. Rritja e normës së refuzimit gjatë periudhës, duket se ka vijuar të mbetet në drejtim të segmentit të "individëve", ndërkohë që për "ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" dhe "ndërmarrjet e tjera", kjo normë është ulur ndjeshëm.*

*Duke e analizuar normën e refuzimit sipas madhësisë së bankave (grupet bankare G1, G2, G3) dhe kategorive të klientëve, rezulton se bankat e vogla (G1) vijojnë të kenë normat më të larta të refuzimit për të tre kategoritë e klientëve, por në rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Normat e refuzimit të bankave të mesme (G2) dhe atyre të mëdha (G3), gjithashtu kanë shfaqur prirje rënëse kundrejt segmentit të ndërmarrjeve dhe prirje rritëse kundrejt individëve.*

*Duke analizuar normën e refuzimit të bankave ndarë sipas pronësisë në banka vendase dhe të huaja, rezulton se gjatë viteve të fundit, kjo normë për bankat vendase ka qenë vazhdimisht më e ulët krahasuar me bankat e huaja. Për 6-mujorin e parë të 2019-ës, norma totale e refuzimit të aplikimeve për kredi nga bankat e huaja (ndaj numrit total të klientëve) është rritur në nivelin 18.7% (nga 14,1% e rezultuar një 6-mujor më parë), ndërsa për bankat vendase norma ka rënë në 7% (nga 7.4% e rezultuar 6-mujorin e kaluar). Sipas segmenteve të klientelës, bankat e huaja kanë qenë më refuzuese ndaj aplikimeve për kredi të "individëve",*

Grafik 60. Ecuria e numrit të aplikimeve të marra në shqyrtim dhe norma e refuzimit të kredive




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 61. Norma e refuzimit të kredive – sipas grupeve bankare dhe kategorisë së klientëve




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 62. Norma e refuzimit të kredive - banka vendase dhe të huaja




Burimi: Banka e Shqipërisë.

*dhe më pranuese ndaj "ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme" dhe "ndërmarrjeve të tjera". Nga ana tjetër, norma e refuzimit të bankave vendase ka rënë gjatë periudhës, kundrejt segmentit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha dhe individëve, dhe është rritur kundrejt llojeve të tjera të ndërmarrjeve.*

*Duhet mbajtur parasysh që luhatjet e normave të refuzimit të bankave vendase dhe të huaja nga prirjet e deritanishme, mund të jenë dhe rezultat i riklasifikimit të grupeve për shkak të ndryshimit të pronësisë së kapitalit të dy prej bankave nga të huaja në shqiptare[II].*

*Në përgjithësi, nga analiza e mësipërme mund të konkludohet se ecuria e numrit të aplikimeve të shqyrtuara nga bankat gjatë gjysmës së parë të vitit 2019, tregon për një kërkesë ende të moderuar, por në rritje për kredi nga të gjitha segmentet e klientelës. Bankat mbeten përgjithësisht hezituese kundrejt segmentit të individëve, ndërkohë që preferenca e tyre për të kredituar "ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" dhe "ndërmarrjet e mëdha" është rritur gjatë periudhës.*

[I] *Përkatësisht rritje vjetore me 0.6% nga "ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" dhe rënie vjetore me 11.4% nga "ndërmarrje të tjera".*

[II] *Në tremujorin e parë të vitit 2019, për shkak të ndryshimit të aksionerëve kontrollues, Banka Ndërkombëtare Tregtare dhe Banka Tirana, kaluan nga banka me kapital të huaj në banka me kapital shqiptar.*

## 6.1.3 DEPOZITAT

**(60) Në fund të periudhës, niveli i depozitave të mbajtura nga publiku në sektorin bankar ishte 1,146 miliardë lekë.** Kryesisht, për shkak të efektit të thyerjes strukturore, teprica e depozitave ishte 2.9% më e ulët se në fund të vitit të kaluar (34 miliardë lekë), dhe pothuajse e pandryshuar kundrejt një viti më parë. Gjatë periudhës, rritje kanë shënuar vetëm depozitat në lekë, ndërsa kategoritë e tjera të depozitave kanë shënuar rënie.

*Tabelë 8. Të dhëna mbi ecurinë e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës*

| | Treguesi dhe njësia | Mld lekë | Struktura (% ndaj totalit) | | Ndryshimi (%) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Periudha | 06/2019 | 06/2018 | 06/2019 | 6-mujore | Vjetor | 6-mujore | Vjetor |
| Sipas afatit | Llogari rrjedhëse | 387 | 34 | 34 | (2.5) | 2.4 | 1.5 | 6.7 |
| | Depozita pa afat | 130 | 11 | 11 | 4.6 | 18.1 | 9.4 | 24.3 |
| | Depozita me afat | 613 | 54 | 54 | (4.6) | (4.3) | (0.5) | (0.1) |
| Sipas subjektit | Sektori publik | 26 | 2 | 2 | (2.5) | (3.3) | 9.5 | 8.6 |
| | Biznese | 155 | 15 | 14 | (11.5) | (7.3) | (0.6) | 4.8 |
| | Individë | 964 | 83 | 84 | (1.4) | 1.3 | 1.3 | 4.1 |
| Sipas monedhës | Depozita në Lek | 562 | 47 | 49 | 1.5 | 3.2 | 2.0 | 3.7 |
| | Depozita në valutë | 584 | 53 | 51 | (6.8) | (3.0) | 0.4 | 4.9 |
| | Stoku i depozitave | 1,146 | 100 | 100 | (2.9) | (0.0) | 1.2 | 4.3 |

*'* - duke përjashtuar efektin e thyerjes strukturore*
*Burimi: Banka e Shqipërisë.*

**(61) Nëse do të përjashtohej efekti i thyerjes strukturore, depozitat do të rezultonin 1% më të larta në krahasim me 6 muaj më parë (13 miliardë lekë).** Thyerja strukturore ka ndikuar kryesisht në vlerat e raportuara për depozitat me afat, depozitat e individëve dhe depozitat në valutë për të cilat normat e korrigjuara të rritjes vjetore do të ishin përkatësisht 0%, +4% dhe +5%, nga përkatësisht -4%, +1% dhe -3%.

Grafik 63. Përbërja e rritjes së depozitave sipas afatit (majtas) dhe monedhës (djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(62) Në ecurinë e depozitave, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat kanë ruajtur kontributin pozitiv, ndërsa depozitat me afat kanë ruajtur kontributin negativ.** Që nga mesi i vitit 2016, depozitat pa afat të individëve kanë dhënë një kontribut të qëndrueshëm dhe pothuajse konstant (prej rreth 2 pikë përqindjeje) në rritjen e përgjithshme të depozitave, ndërsa kontributi i llogarive rrjedhëse ka qenë më i madh, por më i luhatshëm. Në krahasim me pesë vjet më parë, pesha e depozitave me afat ndaj stokut të përgjithshëm të depozitave ka rënë në 54%, nga 75%.

**(63) Mjedisi me norma të ulëta interesi vijon të mbështesë preferencën e klientëve për depozita pa afat dhe llogari rrjedhëse ndaj depozitave me afat.** Kjo preferencë është më e theksuar për kursimet në monedhë të huaj. Depozitat me afat, të mbajtura kryesisht nga sektori i individëve, kanë peshën kryesore në depozitat në lekë (rreth 60%), por zënë më pak se 50% të depozitave të përgjithshme në valutë.

**(64) Në krahasim me një vit më parë, struktura e depozitave sipas monedhës ka ndryshuar në favor të monedhës vendase, si pasojë e rritjes së fortë të depozitave në lekë dhe tkurrjes së depozitave në monedhë të huaj.** Rritja vjetore prej 3% në depozitat në lekë është mbështetur tërësisht nga rritja në llogaritë rrjedhëse të individëve, të cilat kanë vijuar të zgjerohen me ritme të shpejta (mbi 10% në vit), ndërkohë që depozitat me afat në lekë kanë mbetur pothuajse të pandryshuara. Ecuria e depozitave në valutë, që aktualisht zënë

51% të tepricës së depozitave, është përcaktuar nga rritja e depozitave pa afat dhe rënia në depozitat me afat të individëve. Nëse nuk do të merrej në konsideratë ndryshimi strukturor, ndryshimi mesatar vjetor gjatë periudhës për depozitat pa afat dhe ato me afat të individëve në valutë do të ishte përkatësisht +20% dhe +1%, nga +18% dhe -7%.

Grafik 64. Ecuria e depozitave të individëve sipas afatit dhe valutës




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 65. Përbërja e rritjes së depozitave sipas afatit, sektorëve dhe valutës




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(65) Mbiçmimi i lekut ndaj euros dhe dollarit amerikan, ka dhënë ndikim pakësues në vlerën e raportuar të depozitave[32], por ky efekt ka qenë më i ulët se në periudhat e mëparshme.** Ky efekt pakësues vlerësohet në rreth 3 miliardë lekë, dhe ai ka thelluar edhe më tej ndikimin negativ të thyerjes strukturore në ecurinë e depozitave në valutë.

Grafik 66. Raporti i llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat ndaj totalit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 67. Ecuria e depozitave sipas valutës dhe efekti i kursit të këmbimit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

[32] *Nëpërmjet uljes së kundërvlerës në lekë të depozitave në valutë.*

**(66) Normat mesatare të interesit për depozitat e reja, kanë shënuar rënie për lekun dhe ndryshime të papërfillshme për valutat.** Për depozitat në lekë, kontributin në rënien e normës mesatare të interesit e ka dhënë ulja me rreth 0.3 pikë përqindjeje në 0.7% e normës mesatare të interesit për depozitat me afat. Kjo rënie ka ngushtuar diferencën me normat e interesit për depozitat pa afat dhe llogaritë rrjedhëse, e cila në vitin 2018 ishte deri në 0.9 pikë përqindjeje. Për depozitat në monedhën euro, normat e interesit për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me afat vijojnë të qëndrojnë në nivele shumë të ulëta dhe diferenca midis tyre është rreth 0.1 pikë përqindjeje.

Grafik 68. Flukset e reja të llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat në lekë dhe Euro




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 69. Normat e interesit për depozitat e reja në lekë dhe Euro




Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 6.1.4 RREZIKU I LIKUIDITETIT

**(67) Sektori bankar ka vijuar të kryejë aktivitetin e tij në kushtet e një likuiditeti të bollshëm dhe të qëndrueshëm.** Treguesit e likuiditetit në lekë dhe në valutë mbeten dukshëm mbi kufijtë e poshtëm të përcaktuar nga aktet rregullative. Burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditues të bankave mbeten depozitat, të cilat mbulojnë mbi dy herë vëllimin e kredive të sektorit. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2019, raporti "hua/depozita" shënoi 49%, duke rënë me rreth 2 pikë përqindjeje ndaj një viti më parë, por pa shënuar ndryshim të dukshëm ndaj fundit të vitit 2018. Efekti i thyerjes strukturore rezultoi në një rënie të lehtë të raportit në nivelin 48% në muajin janar, duke qenë se efekti relativ i ndryshimit strukturor ishte më i ndjeshëm në stokun e kredisë në krahasim me stokun e depozitave.

**(68) Nivelet e aktiveve likuide në bilancet e bankave vijojnë të mbeten të larta, duke reflektuar ecurinë e ngadaltë të aktivitetit kreditues.** Në fund të muajit qershor 2019, raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar ishte 34.8% ose rreth 0.5 pikë përqindjeje më i lartë ndaj një gjashtëmujori më parë. Kjo ecuri reflekton tkurrjen më të madhe të totalit

të aktivit në krahasim me masën e pakësimit të aktiveve likuide në bilancin e bankave. Ecuria raportit të aktiveve likuide ndaj totalit të detyrimeve afatshkurtra shënoi gjithashtu rritje me 1.2 pikë përqindjeje, duke arritur në nivelin 47.4%.

Grafik 70. Tregues të likuiditetit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 71. Maturimi mesatar i mbetur




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(69) Hendeku negativ mes aktiveve dhe detyrimeve afatshkurtra sipas segmenteve të maturitetit kontraktual të mbetur[33] për periudhën deri në 3 muaj, është zgjeruar gjatë periudhës.** Hendeku i përgjithshëm vijon të jetë pozitiv dhe ka mbetur pothuajse i pandryshuar ndaj fundit të vitit të kaluar, duke shënuar rreth 6% të aktiveve të sektorit bankar. Për monedhat Lekë dhe Euro, të cilat kanë peshën më të madhe në aktivet dhe detyrimet e sektorit bankar, hendeku negativ për shportën "1 ditë deri në 3 muaj" ishte sa përkatësisht -14% dhe -6% e aktiveve dhe ka ardhur duke u thelluar gjatë dy viteve të fundit.

Grafik 72. Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve për aktivet dhe pasivet në Lek (majtas) dhe në Euro (djathtas), në % ndaj totalit të aktivit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

33 *I llogaritur si raporti i "diferenca midis aktiveve dhe pasiveve" ndaj "totali i aktiveve" për secilën shportë të maturitetit të mbetur. Në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve janë përfshirë edhe zërat jashtë bilancit.*

Gjatë kësaj periudhe, është regjistruar një përmirësim i pozicionit negativ dhe përkeqësim i pozicionit pozitiv në monedhën euro për shportat "3 muaj – 1 vit" dhe "1-5 vjet". Vlerat negative, tregojnë përgjithësisht një karakteristikë të pranuar të veprimtarisë bankare, ku afati mesatar i investimeve (tituj, depozita, kredi) është më i gjatë sesa afati mesatar i detyrimeve që i financojnë këto investime (depozitat nga publiku). Në rastin e Shqipërisë, prania e aktiveve likuide në vlera të larta, shërben për të zbutur sinjalet që përcjell mospërputhja në bilanc sipas afateve të maturimit.

(70) **Gjatë periudhës është vërejtur një rritje në diferencën midis maturimit mesatar të aktiveve dhe të detyrimeve.** Në fund të muajit qershor të vitit 2019, kjo diferencë ishte rreth 20.3 muaj, nga 19.6 muaj në fund të vitit 2018. Duke u përqendruar te kreditë dhe depozitat, vërehet që maturiteti i mbetur i kredisë, pavarësisht se ra ndjeshëm në 45.6 muaj nga 47.4, qëndron pranë vlerës mesatare të tri viteve të fundit, duke reflektuar dhe prirjen e bankave për të kredituar për periudha më afatgjata. Maturiteti i mbetur i depozitave, të cilat përfaqësojnë kategorinë më të rëndësishme të detyrimeve, ka mbetur pothuajse i pandryshuar dhe shënonte 7.6 muaj në fund të periudhës.

(71) **Vlera e linjave të financimit nga grupet bankare zotëruese vijon të zërë një peshë shumë të ulët në burimet e financimit të sektorit bankar.** Sipas raportimit të fundit të periudhës, totali i vlerës së këtyre linjave ishte thuajse i papërfillshëm, nga rreth 3 miliardë lekë në fund të periudhës së kaluar. Shkalla e përdorimit të këtyre linjave shënonte 16% gjatë gjashtëmujorit të kaluar dhe 13.7% një vit më parë.

### 6.1.5 RREZIQET E TREGUT

#### *RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT*

(72) **Nivelet e pozicionit të hapur neto në valutë tregojnë për një ekspozim të kufizuar dhe në rënie ndaj ndikimit të drejtpërdrejtë në bilancin e bankave të luhatjeve të kursit të këmbimit.** Si treguesi i agreguar për të gjitha bankat, ashtu edhe treguesi për grupet e bankave sipas madhësisë ka vlera shumë më të ulëta në krahasim me kufirin e sipërm prej 30% të kapitalit rregullator të përcaktuar nga rregullorja përkatëse.

(73) **Pozicioni i hapur neto valutor i sektorit bankar në raport me kapitalin rregullator, ka rënë gjatë periudhës.** Në fund të periudhës, pozicioni i hapur valutor neto i sektorit bankar ishte "në blerje" dhe sa 4.5% e kapitalit rregullator, ose 3.3 pikë përqindjeje më i ulët krahasuar me fundin e vitit 2018 dhe 3.1 pikë përqindjeje më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Ecuria e këtij treguesi për sektorin bankar është diktuar kryesisht nga grupi i bankave të mëdha, të cilat vijojnë të ruajnë pozicion të hapur valutor "në blerje". Ky pozicion ishte sa 7.3% e kapitalit rregullator, duke qenë dukshëm

më i ulët në krahasim me dy gjashtëmujorët e kaluar[34], Kjo ecuri për grupin e bankave të mëdha është ndikuar nga ulja e pozicionit të hapur në "blerje" në monedhën euro. Grupi i bankave të vogla ka thelluar pozicionin e hapur neto "në shitje" në nivelin 13.5% të kapitalit rregullator. Grupi i bankave të mesme paraqet ekspozimin më të ulët ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, duke mbajtur një pozicion neto të hapur valutor "në shitje" në nivel mjaft të ulët (sa 1% e kapitalit rregullator).

Grafik 73. Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator për sektorin (majtas) dhe grupet sipas madhësisë (djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 74. Ecuria e komponentëve të indeksit për sektorin bankar.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(74) Gjatë periudhës, ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit ka rënë.** Në fund të periudhës, treguesi i mospërputhjes valutore[35] për të gjitha monedhat ishte sa 16.8% e totalit të aktiveve, nga 17.8% dhe 17.3% në fund të vitit 2018 dhe një vit më parë. Rënia është diktuar nga rënia më e madhe e aktiveve në valutë (-7.1%) në krahasim me rënien e pasiveve në valutë (-6.5%) dhe kjo ecuri lidhet edhe me efektin e thyerjes strukturore. Ecuria e indeksit është përcaktuar nga rënia e vlerës së indeksit të euros në nivelin 16.5% të totalit të aktiveve, nga 17.5% në gjashtëmujorin e kaluar dhe 17.0% një vit më parë.

[34] *Pozicioni i hapur i bankave të mëdha ishte përkatësisht 3.8 pikë përqindjeje dhe 4.3 pikë përqindjeje më i ulët ndaj vlerës së dhjetorit dhe qershorit të vitit 2018.*

[35] *Treguesi i mospërputhjes valutore mat shkallën e mbulimit të pasiveve në valutë të sektorit bankar, me aktivet në valutë të netuara me kredinë në valutë për rezidentët. Një vlerë e ulët e raportit të këtij treguesi ndaj aktiveve tregon ekspozim të ulët ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit. Për llogaritjen e treguesit të mospërputhjes valutore, referohuni Raportit të Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.*

**(75) Në ecurinë e indeksit të mospërputhjes valutore gjatë periudhës ka ndikuar rënia në vlerat e indekseve për grupin e bankave të mëdha.** Grupi i bankave të mëdha vijon të regjistrojë vlerat më të ulëta të indeksit të mospërputhjes valutore. Në fund të periudhës, indeksi total për bankat e mëdha shënoi 11.6%, nga 13.6% në gjashtëmujorin e kaluar dhe 12.6% një vit më parë. Kontributi kryesor vjen nga rënia e indeksit në monedhën evropiane në nivelin 11.9%. Për grupin e bankave të vogla dhe atyre të mesme, indekset u rritën me 1 deri në 1.5 pikë përqindjeje, në përkatësisht 30.5% dhe 28.4%. Vlerat e indekseve sipas grupeve[36] tregojnë që bankat e mëdha kanë ekspozimin më të ulët, ndërsa bankat e vogla kanë ekspozimin më të lartë ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit. Për grupin e bankave të vogla dhe bankave të mesme, ndikimin kryesor në rritjen e indeksit të përgjithshëm të grupit e ka dhënë ndryshimi në vlerën e indeksit për monedhën euro.

Grafik 75. Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore sipas monedhave




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 76. Mospërputhja valutore sipas monedhave




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 77. Mospërputhja valutore për grupet sipas madhësisë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## *RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT*

**(76) Ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të normës së interesit vijon të mbetet i kufizuar dhe treguesi i përdorur për të matur ekspozimin ka shënuar rënie të lehtë gjatë periudhës.** Pozicioni total neto i ponderuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator të sektorit bankar, qëndron në nivele të ulëta. Ky pozicion

[36] *Madhësia e indeksit është në përpjesëtim të zhdrejtë me shkallën e mbulimit të detyrimeve në valutë me aktive në valutë.*

ishte sa 1.9% e kapitalit rregullator[37] në fund të periudhës, dhe shënoi rënie në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë. Rënia e treguesit është kushtëzuar nga ecuria e pozicionit neto për veprimtaritë me normë interesi të pandryshueshme (FIR) [38], i cili në fund të periudhës është zhvendosur në kahun negativ. Në krahasim me fundin e vitit 2018, gjatë periudhës është vërejtur një zgjerim i pozicionit pozitiv për lekun dhe thellim i pozicionit negativ për monedhën Euro. Pozicioni neto për veprimtaritë me normë interesi të ndryshueshme (VIR), ka shënuar rritje gjatë periudhës, por qëndron në nivele më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Ndonëse pozicioni total neto është pozitiv, në kushtet kur mbulimi me kapital rregullator i këtyre pozicioneve mbetet i lartë dhe hapësira për ulje të mëtejshme të normave të interesit është e kufizuar, kostot që mund t'i vijnë sektorit bankar për shkak të uljes së mëtejshme të normave të interesit mund të përthithen lehtësisht.

**(77) Sipas monedhave, vlera e pozicionit total neto ndaj kapitalit rregullator, është ndikuar nga zgjerimi i pozicionit pozitiv në monedhën vendase dhe thellimi i pozicionit negativ në monedhën Euro.** Pozicioni neto në euro për të tre grupet e bankave shfaq vlera të ulëta negative dhe është zgjeruar lehtë ndaj periudhës së kaluar. Pozicioni në dollarë amerikanë është pozitiv, ka vlera shumë të vogla dhe mbahet nga bankat e mëdha.

Grafik 78. Pozicioni total neto i ponderuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator, në %




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 79. Hendeku sipas monedhave ndaj kapitalit rregullator, në %




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(78) Sipas afatit të maturimit, vlera e pozicionit total neto ndaj kapitalit rregullator është ndikuar nga rënia e pozicionit pozitiv për maturitetin afatgjatë dhe zgjerimi i pozicionit negativ për maturitetin afatmesëm.** Në fund të periudhës,

[37] *Sipas rregullores përkatëse, vlera absolute e këtij treguesi (aktive të ndjeshme ndaj normës së interesit minus detyrimet e ndjeshme ndaj normës së interesit) nuk duhet të kapërcejë kufirin prej 20% të kapitalit rregullator.*

[38] *Pozicionet e ndjeshme ndaj normës së interesit klasifikohen në pozicione me normë interesi fikse (FIR) dhe pozicione me normë interesi të ndryshueshme (VIR), sipas afatit dhe sipas monedhave.*

pozicioni neto i ponderuar për maturitetin afatgjatë ra me 1.4 pikë përqindjeje, në nivelin 5.8% ndaj kapitalit rregullator kundrejt fundit të vitit 2018. Kontributin kryesor në këtë zhvillim e dha rënia me 1.4 miliardë lekë e pozicionit neto afatgjatë me normë fikse interesi në Euro. Për maturitetin afatmesëm, pozicioni negativ midis mjeteve dhe detyrimeve ishte sa 4.6% e kapitalit rregullator në fund të periudhës, duke u zgjeruar me 0.4 pikë përqindjeje në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të parë dhe me 1.2 pikë përqindjeje ndaj një viti më parë. Ndryshimet në maturitetin afatshkurtër nuk ishin të rëndësishme.

Grafik 80. Pozicioni neto i ponderuar sipas monedhave dhe grupeve ndaj kapitalit rregullator, në %




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 81. Pozicioni neto i ponderuar sipas afatit ndaj kapitalit rregullator, në %.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(79) Bankat e mesme kanë ekspozimin më të madh ndaj rrezikut të normës së interesit.** Vlera e pozicionit total neto ndaj kapitalit rregullator për këtë grup bankash shënon 3.9%, dhe kontributin kryesor në këtë vlerë e jep aktiviteti në lekë, për të cilin treguesi shënon sa 6.4% e kapitalit rregullator. Ky pozicion ka ardhur duke u zgjeruar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2019. Bankat e mëdha e kanë ekspozimin total sa 1.4% e kapitalit rregullator dhe peshën kryesore e ka ekspozimi në lekë (2.4%). Grupi i bankave të vogla paraqet ekspozimin më të ulët ndaj rrezikut të luhatjes së normave të interesit (-0.6% e kapitalit rregullator) dhe ekspozimin kryesor e ka në monedhën evropiane (-1.7%).

**(80) Rreziku i tërthortë ndaj ndryshimit të normave të interesit[39] ka shënuar rënie gjatë periudhës.** Norma e ponderuar e interesit të kredisë ka rënë me 0.5 pikë përqindjeje krahasuar me fundin e vitit 2018, ndërsa norma e ponderuar e depozitave ka rënë me 0.1 pikë përqindjeje. Në krahasim me një vit më parë, *spread*-i është zvogëluar për të tre monedhat, dhe kjo ecuri ka sjellë një rënie të *spread*-it të përgjithshëm me 0.4 pikë përqindjeje.

[39] *Ky rrezik i referohet ndikimit që ndryshimi në normën e interesit jep tek klientët e bankave. Për shembull, pavarësisht se rritja e normës së interesit mund të ketë një ndikim pozitiv mbi bilancin e bankës (për shkak të vlerës pozitive të pozicionit neto mes aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit), kjo rritje do të ketë efekt negativ tek aftësia paguese e huamarrësve të bankës kur kredia është dhënë me normë interesi të ndryshueshme (rreziku i terthortë).*

Kontributin kryesor në këtë ecuri e kanë dhënë normat e interesit në monedhën vendase. Në fund të periudhës, diferenca midis normave të interesit të kredive dhe depozitave të reja të sektorit bankar për secilën nga monedhat kryesore ishin 3.6 pikë përqindjeje për Euron, 3.3 pikë përqindjeje për USD-në dhe 5.26 pikë përqindjeje për Lekun.

Grafik 82. Norma e ponderuar e interesit të kredisë dhe depozitave me afat dhe spread i normave të interesit, në %




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 83. Diferenca e normave të ponderuara të interesit të kredisë dhe depozitave me afat sipas monedhave, në p.p.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

*HAPËSIRË INFORMUESE 6.2: INDEKSI I SHËNDETIT BANKAR*

*Indeksi i shëndetit bankar përfaqëson një vlerësim të përgjithshëm të kushteve bazë dhe faktorëve të qenësishëm të rrezikut që ndikojnë në stabilitetin e sektorit bankar dhe atë të bankave individuale. Indeksi përbëhet nga pesë tregues, të cilat përfaqësojnë pesë dimensione të sektorit bankar: kapitali; cilësia e aktiveve; përfitueshmëria; likuiditeti dhe eficienca. (MISHRA et.al (RBI); 2013):*

***Indeksi përmbledhës i treguesve kryesorë që përdoren për të ndjekur ecurinë dhe situatën e stabilitetit bankar është përmirësuar krahasuar me një vit më parë.*** *Vlera e tij ra në nivelin 0.43, nga 0.46 që shënonte në fund të qershorit 2018[1]. Treguesit përbërës të indeksit, të cilët kanë shfaqur ecuri më të mirë, vitin e fundit janë: kapitalizimi, cilësia e aktiveve, likuiditeti dhe eficienca, ndërsa "përfitueshmëria" ka kontribuar në rritjen e rrezikut dhe njëkohësisht në rënien e indeksit të shëndetit të bankave, duke arritur në 0.48, nga 0.43 në fund të muajit qershor 2018. Krahasuar me një vit më parë është vërejtur rënie në fitimin e bankave, ndikuar kryesisht nga rënia e të ardhurave neto nga interesi.*

***Kontributin kryesor në rrezik vijon ta japë cilësia e aktiveve, por përmirësimi i cilësisë së kredisë ka sjellë rënien e këtij kontributi.*** *Që prej fillimit të vitit 2015, kontributi i këtij treguesi në rrezik ka rënë ndjeshëm dhe në mënyrë të vazhdueshme, duke shkuar nga niveli 0.71 në mars të 2015-ës, në nivelin 0.49 në qershor të 2019-ës. Përmirësimin më të dukshëm në harkun kohor të një viti e ka treguesi "eficienca", i cili reflekton një menaxhim më eficient të shpenzimeve, të shprehur në rënie të shpenzimeve të veprimtarisë dhe kryesisht të atyre për personelin. Treguesit e "kapitalit" dhe të "likuiditetit" gjithashtu kanë pasur ecuri pozitive, duke kontribuuar në përmirësimin e shëndetit të bankave. Treguesi i*

*likuiditetit është ndikuar nga rritja e konsiderueshme e raportit të aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve. Përmirësimi në treguesin e kapitalit pasqyron rritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar në krahasim me një vit më parë. Gjatë gjashtë viteve të fundit (2013-2019), indeksi i agreguar i shëndetit bankar ka regjistruar pirje në rënie, që do të thotë përmirësim i shëndetit dhe qëndrueshmëri më e lartë e bankave.*

Grafik 84. Indeksi i Shëndetit Bankar*




*Rritja e vlerës së treguesit tregon stabilitet më të ulët. Gjerësia e çdo dimensioni nënkupton kontributin e tij ndaj rrezikut.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 85. Harta e shëndetit bankar*




*Larg nga qendra nënkupton rritje të rrezikut, në një interval nga 0 në 1.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Indeksi i shëndetit për bankat e mesme (G2) dhe bankat e vogla (G1) nuk ka ndryshuar në krahasim me një vit më parë. Për grupin e bankave të vogla vërehet përkeqësim në treguesin e "përfitueshmërisë", ndërkohë që "cilësia e aktiveve" dhe "likuiditeti" janë përmirësuar. Ndërkohë, për grupin e bankave të mesme është evidentuar përkeqësim në treguesin e kapitalit, ndërsa treguesit e tjerë kanë mbetur në pothuajse të njëjtat nivele. Përkeqësimi i treguesit të kapitalit, shoqëruar me rënien e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat e mesme, ka të bëjë kryesisht me ndryshimet strukturore të ndodhura kohët e fundit në sistemin bankar. Bankat e mëdha (G3) raportojnë përmirësim të indeksit në*

Grafik 86. Harta e shëndetit bankar e ndarë në grupe, sipas madhësisë së bankave




*Larg nga qendra nënkupton rritje të rrezikut, në një interval nga 0 në 1.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

*harkun kohor të një viti. Përmirësimi reflekton përmirësimin e likuiditetit, cilësisë së aktiveve, eficiencës dhe kapitalizimit. Bankat e mëdha kanë vlerën më të ulët të indeksit, gjë që tregon shëndet më të mirë dhe stabilitet më të lartë në krahasim me dy grupet e tjera.*

[1] *Rënia e vlerës së indeksit nënkupton përmirësim të shendetit bankar dhe anasjelltas.*

## 6.2 REZISTENCA E SEKTORIT BANKAR

Për të vlerësuar rezistencën e sektorit bankar analizohen treguesit e performancës financiare dhe të kapitalizimit të veprimtarisë, si edhe kryhen ushtrimet e provës së rezistencës që vlerësojnë reagimin e treguesve të kapitalizimit dhe të likuiditetit të sektorit bankar ndaj skenarëve të supozuar.

### 6.2.1 REZULTATI FINANCIAR

(81) **Në fund të periudhës, sektori bankar raportoi një rezultat financiar pozitiv prej rreth 10.5 miliardë lekësh.** Ky rezultat ishte përkatësisht 0.5 dhe 1 miliardë lekë më i ulët në krahasim me rezultatin e gjysmës së parë të vitit për vitet 2018 dhe 2017. Ndikim negativ në fitimin e bankave ka dhënë rënia e rezultatit neto nga interesat dhe rënia e konsiderueshme në rimarrjet e provigjioneve për mjete të tjera financiare, ndërkohë që kthimi në fitim i humbjeve nga instrumentet financiare, e ka përmirësuar ndjeshëm rezultatin financiar të sektorit bankar. Rënia në rezultatin financiar është reflektuar në rënie të lehtë të treguesve mesatarë të përfitueshmërisë së sektorit. Kthimi nga aktivet (RoA) dhe kthimi nga kapitali (RoE) kanë rënë në 1.5% dhe 14.3%, nga përkatësisht 1.52% dhe 14.8% një vit më parë.

(82) **Rezultati financiar ishte i shpërndarë në mënyrë të përshtatshme midis bankave sipas madhësisë së tyre.** Disa banka që kanë rreth 50% të aktiveve të sektorit, raportojnë një kthim nga aktivet në intervalin 2-3% dhe kthim nga kapitali midis 17% dhe 20%, ndërkohë që vetëm 4 banka që së bashku zënë më pak se 4% të aktiveve të sektorit, e mbyllën periudhën me rezultat financiar negativ.

(83) **Rezultati neto nga interesat ra me 8% (ose 2 miliardë lekë) në 20.5 miliardë lekë, si pasojë e një rënieje në pothuajse të njëjtën masë në të ardhurat nga interesat.** Gjatë gjysmës së parë të vitit 2019, bankat kanë arkëtuar rreth 25 miliardë lekë nga interesat dhe kanë shpenzuar rreth 4 miliardë lekë për të paguar interesat. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat ishin rreth 7% ose 2 miliardë lekë më pak, ndërkohë që shpenzimet kanë mbetur pothuajse të pandryshuara. Rënia në të ardhurat nga interesat reflekton rënien në të ardhurat nga interesat e veprimeve me klientët (kredia),

ndërsa në anën e shpenzimeve bankat kanë raportuar një rënie të lehtë në interesat e paguara për letrat me vlerë. Rënia e marzhit neto nga interesat në 3.4% nga 3.8% një vit më parë, reflekton si rënien në rezultatin neto nga interesat (numëruesi), ashtu edhe rritjen në nivelin e aktiveve mesatare që sjellin të ardhura (emëruesi).

**(84) Një ndikim pozitiv të ndjeshëm në rezultatin financiar të sektorit bankar kanë dhënë të ardhurat nga veprimtaritë e tjera (jo të lidhura me interesat), të cilat shënuan rreth 6 miliardë lekë.** Të ardhurat e sektorit bankar nga gjobat dhe komisionet përfaqësojnë pjesën më të madhe të të ardhurave jo nga interesat dhe kanë ruajtur nivelin e një viti më parë (rreth 5 miliardë lekë), por në ndryshim nga një vit më parë, bankat kanë regjistruar një rezultat pozitiv në llogarinë e humbjeve/fitimit nga instrumentet financiare. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë ishin rreth 16 miliardë lekë dhe kanë shënuar një rënie të lehtë, si pasojë e zvogëlimit të zërit "shpenzime të tjera" dhe një tkurrjeje të lehtë në zërin "shpenzime për personelin".

Grafik 87. Përbërësit e rezultatit financiar




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 88. Treguesit e përfitueshmërisë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(85) Gjatë periudhës, bankat nuk kanë regjistruar rimarrje të provigjioneve për kredi dhe për mjete të tjera financiare.** Gjatë periudhës janar – qershor 2018, vlerat e rimarrjeve të provigjioneve për kreditë e humbura dhe për mjetet financiare ishin përkatësisht 1.3 miliardë dhe 5.6 miliardë lekë, ndërkohë që për gjashtëmujorin e parë të këtij viti bankat kanë rimarrë më pak se 1 miliardë lekë nga provigjionet për mjete financiare dhe kanë shpenzuar rreth 0.5 miliardë lekë për kreditë e humbura.

Grafik 89. Marzhi neto nga interesat




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 90. Shpenzimet e veprimtarisë dhe të ardhurat bruto




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(86) Kostot e veprimtarisë u mbuluan në nivele të mira nga të ardhurat e veprimtarisë.** Raporti i shpenzimeve të veprimtarisë ndaj të ardhurave ishte 59% dhe ka rënë ndjeshëm nga 80% një vit më parë, por është i krahasueshëm me raportin mesatar të kostove ndaj të ardhurave për gjashtëmujorin e parë të viteve 2011 – 2017. Gjatë kësaj periudhe është vënë re një rritje më e shpejtë e shpenzimeve të tjera të veprimtarisë në krahasim me shpenzimet e personelit. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2019, këto dy kategori shpenzimesh regjistruan përkatësisht 10 dhe 6 miliardë lekë.

*HAPËSIRË INFORMUESE 6.3: PËRAFRIM MBI KOSTON E KAPITALIT NË SEKTORIN BANKAR SHQIPTAR*

*Kostoja e kapitalit (CoE)[I] i referohet normës së kërkuar të kthimit nga aksioneri për një investim në kapital. Diferenca midis këtij treguesi dhe kthimit aktual mbi kapitalin (RoE) është një matje e mjaftueshmërisë së fitimit të një banke nga këndvështrimi i aksionerëve të saj. Vlerësimi i kostos së kapitalit në sektorin bankar bazohet në primin e rrezikut të vlerësuar për vendin ku banka kryen veprimtarinë[II] dhe primin e rrezikut të bankës[III]. Bazuar në këta tregues, kostoja e kapitalit për bankat në Shqipëri sipas të dhënave të fundit të gjashtëmujorit të parë të vitit 2019, vlerësohet ndërmjet 9.25% dhe 16.25%, dhe ka një vlerë mesatare prej 12.75%[IV]. Për disa banka të sektorit, aktivet e të cilave zënë rreth 23% të aktiveve të sektorit, normat aktuale të kthimit nga kapitali janë më të ulëta se kostot e vlerësuara të kapitalit. Në nivel sektori, kthimi nga kapitali prej 14.3% ka një vlerë më të lartë nga kostoja mesatare e kapitalit prej 12.75% Kjo do të thotë që në terma mesatarë sektori bankar është në gjendje të mbulojë koston e kapitalit nëpërmjet të ardhurave që gjeneron nga aktiviteti i tij.*

*Kriza ndërkombëtare financiare e vitit 2007, u reflektua edhe në treguesit e shëndetit financiar të vendit tonë, kryesisht përgjatë harkut kohor 2008-2012. Gjatë kësaj periudhe, një numër i konsiderueshëm bankash kanë regjistruar*

*vlera të kthimit nga kapitali shumë më të ulëta edhe në krahasim me normën minimale të vlerësuar të kostos së kapitalit prej 9.25%. Edhe treguesi i kthimit nga kapitali për të gjithë sektorin bankar vendas ra nga një nivel prej rreth 22% në vitet para krizës, në më pak se 1% në vitin 2011. Që nga viti 2017 e këtej, kthimi nga kapitali i sektorit bankar është luhatur pranë normës mesatare të vlerësuar të kostos së kapitalit prej 12.75%.*

*A mundet që bankat të operojnë në mënyrë të qëndrueshme me norma të kthimit nga kapitali më të ulëta sesa kostoja e tij? Kjo është plotësisht e mundur, në kushtet kur kapitali përfaqëson një angazhim afatgjatë të aksionerëve, dhe në kushtet kur bankat operojnë me marzhe pozitive të performancës në bilancin e tyre. Në fakt, sipas Bankës Qendrore Evropiane, kostoja mesatare e kapitalit të bankave në Eurozonë qëndron midis 8% dhe 10%, në një kohë që norma e kthimit nga kapitali është aktualisht mesatarisht 6%. Megjithatë, mosmbulimi i kostos së kapitalit me atë që banka fiton nga investimet që kryen, tregon për aftësinë e saj të kufizuar për të zgjeruar veprimtarinë me burime të brendshme, dhe mund të shoqërohet me rritje të rrezikut në kushtet kur bankat mund të synojnë të rrisin normën e kthimit mbi kapitalin.*

Grafik 91. Ecuria e kthimit nga kapitali RoE në nivel banke kundrejt kostos së kapitalit CoE, para dhe pas krizës financiare ndërkombëtare të 2008




*Secili rreth në ngjyrë blu tregon normën e kthimit nga kapitali i një banke në atë periudhë. Rrethi në ngjyrë gri tregon vitet përpara dhe rrethi në ngjyrë të kuqe tregon vitet pas krizës financiare. Pjesa e ngjyrosur në bojëqielli tregon intervalin e vlerës minimale (9.25%) dhe maksimale (16.25%) të kostos së vlerësuar të kapitalit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

*I Metodologjia për matjen e kostos së kapitalit është prezantuar në Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017.*

*II Vlerësimi për rrezikun e vendit në Shqipëri sipas vlerësimeve më të fundit (janar 2019), shënon 6.25%. Ky vlerësim mbështetet në studimin e Aswath Damodaran "Rreziku i vendit: Përcaktuesit, matjet dhe implikimet"- Stern School of Business, 2016, http://pages.stern.nyu.edu/~adamodar/New_Home_Page/datafile/ctryprem.html.*

*III Në mungesë të këtyre vlerësimeve në Shqipëri, studime të hershme për vendet e zhvilluara sugjerojnë se primi i rrezikut specifik për bankat është ndërmjet intervalit 3 dhe 10%, bazuar në King, M.R., "Kostot e kapitalit për bankat globale: Një perspektivë e CAPM nga 1990 deri 2009" BIS, Raport Tremujor, shtator 2009, http://www.bis.org/publ/qtrpdf/r_qt0909g.pdf .*

*IV Vlerësimi mesatar i kostos së kapitalit llogaritet nga formula: 6.25% + 0.5*(10+3) % =12.75%.*

## 6.2.2 KAPITALIZIMI I VEPRIMTARISË

**(87) Kapitalizimi i veprimtarisë së sektorit bankar ka mbetur në nivele të mira gjatë periudhës.** Në fund të saj, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi 18.5%, nga 18.7% në fund të vitit 2018 dhe nga 17.9% një vit më parë. Bankat e mëdha dhe ato me kapital të huaj kanë nivelin më të lartë të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Që nga tremujori i parë i vitit 2015, në sektorin bankar vendas nuk janë evidentuar raste të rënies së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit nën minimumin rregullator prej 12%, ndërkohë që aktualisht 12 banka kanë një normë mjaftueshmërie më të lartë se 15%. Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar është vërejtur një rritje e numrit të bankave që kanë norma të mjaftueshmërisë së kapitalit në intervalet 20%-30%.

Grafik 92. Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 93. Kontributi vjetor në rritjen e kapitalit sipas instrumenteve përbërës, pikë përqindjeje




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(88) Në ecurinë e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, efekti negativ i rënies së kapitalit rregullator ishte më i madh në krahasim me efektin pozitiv të rënies në aktivet e peshuara me rrezik.** Gjatë periudhës, në vijim të ndryshimeve strukturore që u shoqëruan me konsolidim dhe ndryshim të aksionerëve të disa bankave, kapitali rregullator i sektorit bankar ra me rreth 3%, në nivelin 142 miliardë lekë. Rënia në kapitalin rregullator dha një efekt negativ prej 0.6 pikësh përqindjeje në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit. Nga ana tjetër, në fund të periudhës, aktivet e peshuara me rrezik ishin rreth 770 miliardë lekë ose 17 miliardë lekë më pak ndaj fundit të gjashtëmujorit paraardhës si rezultat i rënies së ekspozimeve ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë[40].

Grafik 94. Kontributi i zërave të mjaftueshmërisë së kapitalit, pikë përqindjeje




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 95. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas madhësisë dhe origjinës së kapitalit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

[40] *Këto ekspozime përfshijnë vlerën e kredisë së akorduar jashtë territorit, ku banka ushtron veprimtarinë nëpërmjet filialeve, degëve ose agjencive të saj. Kjo ecuri, përfaqëson kryesisht efektin e thyerjes strukturore.*

Rënia në këtë tregues dha një kontribut pozitiv prej 0.4 pikësh përqindjeje në ndryshimin e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

**(89) Struktura e aktiveve të peshuara me rrezik sipas rreziqeve nuk ka ndryshuar dhe vijon të dominohet nga aktivet e peshuara me rrezik për rrezikun e kredisë (88%).** Aktivet me rrezik për rreziqet e tregut u pakësuan me 4 miliardë lekë, ndërsa ato për rrezikun operacional ruajtën një nivel të pandryshuar në krahasim me fundin e vitit. Peshat përkatëse të këtyre dy kategorive të aktiveve të peshuara me rrezik ndaj totalit të aktiveve të peshuara me rrezik kanë ruajtur përkatësisht nivelet 2% dhe 10%.

Grafik 96. Shpërndarja e aktiveve të sektorit bankar sipas raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(90) Në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë, nuk janë raportuar ndryshime të ndjeshme në shpërndarjen e aktiveve të peshuara me rrezik për rrezikun e kredisë, si për sektorin në tërësi, ashtu edhe për bankat e grupuara sipas madhësisë dhe vendit të origjinës së kapitalit.** Bankat e vogla paraqesin ekspozim të lartë për kredi të siguruar me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme, ndërsa bankat e mesme dhe ato të mëdha kanë ekspozim më të lartë për kredinë për koorporata dhe kredinë me probleme. Sipas origjinës së kapitalit, si bankat me kapital vendas ashtu edhe ato me kapital evropian, kanë ekspozimin më të lartë për klasën "kredi për koorporata dhe kredi me probleme", ndërsa bankat e klasifikuara me kapital tjetër kanë peshë të lartë të "ekspozimeve të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura".

Grafik 97. Ekspozimet e klasave të kredisë për bankat, sipas madhësisë të aktivitetit dhe origjinës në kapitalit, për qershor 2019




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 98. Treguesi i levës financiare, në herë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(91) Sektori bankar shqiptar karakterizohet nga një raport i përshtatshëm i levës financiare, gjë që konfirmon ruajtjen e një niveli të mirë të kapitalizimit.** Treguesi i levës financiare[41], në muajin qershor të 2019-ës, ishte 9.6 herë në rënie krahasuar me fundin e vitit 2018, dhe i pandryshuar kundrejt një viti më parë. Në nivel banke, treguesi paraqet zhvendosje (rritje), si rrjedhojë e tkurrjes së kapitalit.

### 6.2.3 VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR SIPAS PROVËS SË REZISTENCËS

**(92) Ushtrimi i provës së rezistencës vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar kundrejt zhvillimeve të supozuara ekonomike dhe financiare, për pjesën e mbetur të vitit 2019 dhe vitin 2020.** Rezultatet e përftuara tregojnë se sektori mbetet i qëndrueshëm, pavarësisht zhvillimeve në skenarët e rënduar. Ndonëse këto zhvillime janë ekstreme dhe me një probabilitet të ulët ndodhjeje, ndikimi i tyre në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit vë në dukje nevojën për kapital shtesë në disa prej bankave individuale të sektorit.

Grafik 99. Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(93) Ushtrimi i provës së rezistencës vlerësoi qëndrueshmërinë e sektorit bankar në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit, për periudhën 2019-2020.** Vlerësimi i ndikimit të situatave makroekonomike në gjendjen financiare të sektorit bankar përjashton mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës. Ushtrimi kryhet duke u mbështetur në tre skenarë: skenarin bazë, skenarin e moderuar dhe atë të rënduar. Rezultatet e tyre paraqiten në grafikun në vijim.

**(94) Skenari bazë supozon një rritje ekonomike pozitive dhe me prirje rritëse përgjatë harkut kohor të zhvillimit të ushtrimit të provës së rezistencës.** Në këtë skenar, rritja ekonomike shoqërohet me norma rritjeje pozitive të kreditimit, mbështetur gjithashtu në përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së portofolit të kredisë deri në fund të vitit 2020. Në skenarin e moderuar, rritja ekonomike mbetet pozitive përgjatë të dy viteve të ushtrimit, por dukshëm më e ulët kundrejt vlerave të skenarit bazë; ndërsa në skenarin e rënduar është supozuar një rritje e ekonomisë për pjesën e mbetur të vitit 2019 dhe një tkurrje e ndjeshme e saj për vitin 2020.

**(95) Supozimeve për ecurinë ekonomike në dy skenarët e rënduar, iu mbivendosen supozimet përkatëse për një nënçmim të kursit të këmbimit të monedhës vendase, rritje të normave të interesit dhe përgjysmim të ritmit të**

[41] *Treguesi i levës financiare matet si raport i aktiveve ndaj kapitalit aksioner.*

**kreditimit deri në ndalim të tij.** Këto zhvillime, krahas vlerave në rënie në vëllimin e kredive të fshira, reflektohen në një përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë. Konkretisht, raporti i kredive me probleme përkeqësohet deri në fund të vitit 2020 me përkatësisht deri në 6.3 pikë përqindjeje (skenari i moderuar) dhe 14.8 pikë përqindjeje (skenari i rënduar) ndaj vlerave faktike të muajit qershor të vitit 2019. Këto supozime ndikojnë në një rënie të vlerave të treguesve të kapitalizimit të sektorit bankar, më e ndjeshme për grupe të veçanta bankash dhe kryesisht gjatë vitit të dytë të ushtrimit.

**(96) Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit tregojnë se:**

a. Në skenarin bazë, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të sektorit bankar paraqitet e qëndrueshme dhe në nivele të krahasueshme me vlerën faktike të muajit qershor të 2019-ës. Konkretisht, kjo normë arrin në rreth 18.0% në fund të vitit 2019 dhe rritet në 18.3% në fund të vitit 2020. Këto zhvillime reflektojnë supozimet mbi ritmin e rritjes ekonomike, mbi rritjen pozitive të kredisë ndaj ekonomisë, mbi përmirësimin e mëtejshëm të portofolit të kredisë me probleme dhe ecurinë e favorshme të kursit të këmbimit. Ndërsa, ecuria e supozuar e normave të interesit (shiko grafikun më lart), nisur nga vetë struktura e "aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit deri në 12 muaj", të sektorit bankar, ka dhënë ndikim në kahe të kundërta. Konkretisht, ka ndikuar në uljen e RMK-së së sektorit gjatë vitit të parë të ushtrimit dhe në rritjen e tij përgjatë vitit të dytë. Megjithatë, zhvillimet sipas grupeve bankare tregojnë nivele të larta të kapitalit dhe mbi nivelin minimal të kërkuar nga kuadri rregullativ;

a. Në skenarin e moderuar, RMK-ja e sektorit bankar ulet në nivel prej 13.3% në fund të vitit 2019 dhe 11.4% në fund të vitit 2020. Kjo normë ndikohet nga supozimet për një normë të ulët rritjeje të aktivitetit ekonomik, përgjysmim në ritmin rritës së kredisë, nënçmim të monedhës vendase, rritje të raportit të kredisë me probleme – në vijim të një niveli më të ulët të fshirjeve të kredive të humbura nga bilancet e bankave - dhe humbje nga portofoli në tituj. Bazuar edhe në supozimet e mësipërme dhe rezultatet e përftuara, zhvillimet në banka të veçanta evidentojnë nevojën për injektim kapitali gjatë periudhës kohore dyvjeçare. Numri i bankave që paraqiten të nënkapitalizuara shkon deri në gjashtë në fund të periudhës, duke përbërë rreth 70% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen mesatarisht rreth 10.6 miliardë lekë;

b. Në skenarin e rënduar, RMK-ja e sektorit bankar bie në 11.2% në fund të vitit 2019 dhe në 8.4% në fund të vitit 2020, ndikuar nga supozimet ndjeshëm më të rënduara që përfshin ky skenar. Numri i bankave që bien në nënkapitalizim rritet në tetë dhe këto banka zënë rreth dy të tretat e aktiveve të sektorit. Zhvillimet makroekonomike ekstreme që

përmban skenari, krahas ndalimit të kreditimit të ekonomisë, ndikojnë në përkeqësimin e ndjeshëm të cilësisë së kredisë. Gjithashtu, edhe ky skenar supozon humbje në portofolin e titujve dhe rritje të ekspozimit ndaj rrezikut operacional. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë janë rreth dy herë më të larta.

Grafik 100. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve të provës së rezistencës




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**(97) Bazuar në sa më lart, por dhe nga një këndvështrim krahasues me periudhën paraardhëse, rezultatet aktuale tregojnë për një ndjeshmëri më të lartë të sektorit bankar ndaj zhvillimeve ekonomike dhe financiare të supozuara, duke u reflektuar në nivele më të ulëta të RMK-së në nivel sektori.** Në këtë këndvështrim, edhe nevojat e supozuara për kapital shtesë paraqiten më të larta. Gjithsesi, këto nevoja vlerësohen si të administrueshme nga ana e sektorit bankar në kushtet kur vlera mesatare e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës T4 2018-T2 2019, është rreth 5.6 miliardë lekë.